

Titulli i lëndës: Letërsi botërore II

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Letërsi botërore II
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i tretë Semestri i gjashtë
Numri i orëve në javë:	3+2
Kreditë ECTS:	6 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa 78 E enjte 9:30 - 12
Mësimdhënësi:	Prof. dr. Osman Gashi
Të dhënat kontaktuese:	+383 44 174 174 // osman.gashi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Ky kurs përfshinë materien letrare nga fusha e letërsisë botërore nga shekulli XIV deri në shekullin XIX. Trajton vepra letrare, autorë e dukuri sipas rrjedhës historike (sipas epokave, formacioneve stilistike, drejtimeve, rrymave, lëvizjeve...) si dhe sipas zhvillimeve zhanrore (gjinitë, zhanret e llojet letrare), me theks të veçantë në analizën e veprave më përfaqësuese të të gjithë letërsisë.
Qëllimet e lëndës:	Gjatë ligjëratave, ushtrimeve e konsultimeve si dhe në përfundim të kursit studentët do të kenë mundësi: <ul style="list-style-type: none"> - Të demonstrojnë njohuri për letërsinë e shkruar në vende të ndryshme e në periudha të ndryshme historiko – letrare, për gjuhët, kulturat dhe traditat letrare; - Të tregojnë aftësi për lexime kritike si dhe për shkrime kritike e analitike; - Të përdorin me saktësi literaturën shkencore teoriko – letrare e historiko – letrare;
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Studentët do të arrijnë të marrin informacione dhe të njohin periudhat letrare si: Renesansa, Baroku, Klasicizmi, Iluminizmi, Romantizmi, Realizmi, Natyralizmi, Modernizmi, në letërsitë e ndryshme evropiane; Do të arrijnë të analizojnë strukturën e veprave përfaqësuese të periudhave të sipërpërmendura
Metodat e mësimdhënies:	<i>Ligjërata, seminare, diskutime, punë në grupe, shkrime esesh,</i>

Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 50 %. Vijueshmëria e studentit 10 %; Detyrat individuale të kryera në klasë 10 %; Detyrat individuale të kryera në shtëpi 10 %; Vlerësimi nga testet 20 %; Provimi final 50 %.
Veprat letrare:	Dante Aligieri: Komedia hyjnore (Ferri) ; Xhovani Bokaço: Dekameroni (tri novela) ; Wiliem Shekspiri: Hamleti, Romeo dhe Zhulieta, Ëndërr e një nate vere ; Migel de Servantesi: Don Kishoti i Mançës ; Molieri: Tartufi, Mizantropi ; Xh. Suift: Udhëtimet e Guliverit , D. Defoe: Robinson Kruso ; Johan Wolfgang Gëte: Fausti, Vuajtjet e djaloshit Werter , Divani përëndimor – lindor; Xh. G. Bajron: Çajld Haroldi ; Hajnrih Hajne: Gjermania një përrallë dimri, Atta Troll ; Xh. Leopardi: Poezi ; A. S. Pushkin: Eugjen Onieгинi ; V. Ygo: Katedralja e Parisit ; Poemat „Legjenda e shekujve“, „Ndëshkimet“ ; E. A. Poe: Korbi, Annabel Lee ; Stendal: E kuqja dhe e zeza, Manastiri i Parmës ; G. Flober: Zonja Bovari , Balzaku: Xha Gorio, Iluzionet e humbura, Fshatarët ; Çarls Dikens: Oliver Tuist, David Koperfild ; N. V. Gogoli: Shpirtra të vdekur, Novelat (Hunda, Manteli, Prospekti i Nevës) ; Emil Zola: Zherminal ; Dostojevski: Krim dhe ndëshkim ; Tolstoj: Ana Karenina, Sonata e Krojçerit , Haxhi Murati; A. P. Çehov: Kopshti i qershive, tregime ; Bodler: Lulet e të keqes ;
Literatura shkencore:	Grup autorësh: Historia e letërsisë botërore 3, 4, 5, 6, Prishtinë, 1987 Hasan Mekuli: Letërsi botërore – autorë dhe vepra, Prishtinë 2002 Osman Gashi: Letërsia dhe miti (studime krahasimtare), Prishtinë 2014 Nexhip Gami: Historia e letërsisë së huaj I, II (shek. XIX), shblu, Tiranë 2004

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Humanizmi dhe Renesanca (fryma e Epokës dhe relacionet me Mesjetën; Dante, Petrarka, Bokaço)
Java 2:	Letërsia kalorësiake, romani pikaresk; Periudha elizabetiane në Angli (Shekspiri)
Java 3:	„Shekulli i artë“ i letërsisë spanjolle (Servantesi); Baroku dhe manierizmi
Java 4:	Klasicizmi francez (poetika e tragjedisë dhe komedisë klasiciste. Molieri, Kornej, Rasin)
Java 5:	Iluminizmi, Racionalizmi – fillimet e romanit anglez (Daniel Defoe,

	Xhonatan Suift) <i>Shturm und Drang</i> – Klasika e Weimarit (J. W. Gëte, F. Shiler).
Java 6:	Romantizmi evropian (tiparet e përgjithshme, konceptet dhe parimet krijuese)
Java 7:	Autorë dhe vepra të Romantizmit: Viktor Hygo, Leopardi, Eminesku, Lamartin,
Java 8:	Autorë dhe vepra të Romantizmit: Xhorxh G. Bajron, Leopardi, Pushkin, Hajnrih Hajne;
Java 9:	Proza dhe drama e romantizmit evropian (Pushkin, Hëlderlin, Klaist)
Java 10:	Realizmi (poetika dhe krijimtaria letrare realiste në vendet e ndryshme evropiane)
Java 11:	Romani: Leon Tolstoj, Dostojevski,
Java 12:	Romani (II): Balzak Stendal, Gogol
Java 13:	Naturalizmi dhe Romani i ri (Emil Zola)
Java 14:	Drejtimit moderniste (shek. 19) dhe <i>Avangarda</i> ; Charl Bodler: Lulet e të keqes
Java 15:	Arti për art, Parnasizmi, Impresionizmi, ekspresionizmi

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet e tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.

Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet e tjera, siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet, janë të ndaluara.